

ROLI I KËSHILLAVE LOKALE DHE FUNKSIONIMI I TYRE NË KOMUNËN E FERIZAJT



Ferizaj, shtator 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës Iniciativa për Progres – INPO dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Shtator 2018

® Iniciativa për Progres – INPO

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë Inicativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike apo të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja

| | |
|---------------------------------------|----|
| Rreth INPO-së | 5 |
| Hyrje | 6 |
| Konteksti | 7 |
| Korniza ligjore | 8 |
| Struktura dhe organizimi..... | 11 |
| Procesi dhe integriteti zgjedhor..... | 12 |
| Tubimet zgjedhore | 12 |
| Komisioni i politizuar | 13 |
| Informimi i mangët | 14 |
| Procesi i ankimit | 14 |
| Llogaridhënia institucionale | 15 |
| Përfshirja në politikbërje | 15 |
| Takimet me Kryetarin | 18 |
| Përgjegjësitë e bartura | 19 |
| Qëndrueshmëria financiare | 21 |
| Rekomandimet..... | 22 |

Rreth INPO-së

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës avokohet për çështje shoqërore, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni i Organizatës INPO është për institucione lokale që qeverisen me vlera demokratike ku qytetari është bashkëvendimmarrës, ndërsa INPO për mision ka promovimin e demokratizimit të qeverisjes lokale përmes aktivizmit qytetar dhe përkushtohet në avansimin e vlerave të një shoqërie të hapur.

Vizioni dhe misioni i Organizatës INPO përmbushen përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të Organizatës: (i) Programi për Qeverisje të Mirë, dhe (ii) Programi për Zhvillim Demokratik. Ky dokument është produkt i Programit për Qeverisje të Mirë, program i cili ka për qëllim promovimin e qeverisjes së përgjegjshme duke nxitur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit.

INPO që nga themelimi ka shtyrë përpara agjendat për më shumë transparencë në shpenzimet financiare publike, përfshirjen më të mirë dhe më të gjerë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes publike dhe rritjen e llogaridhënies së zyrtarëve publik të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të këqija në institucionet publike.

Hyrje

Komuna e Ferizajt për të t'i realizuar funksionet dhe përgjegjësitë e saj të rregulluara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ajo duhet të mbështetë themelimin dhe konsolidimin e Këshillave Lokale (KL-ve), të njohura gjithashtu si Bashkësi Lokale (BL), të cilat përfaqësojnë fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Sipas Statutit, komuna është e përbërë nga 54 fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, përfshirë qytetin e Ferizajt, të cilat përfaqësohen nga KL-të, roli i të cilave është zhvillimi i demokracisë lokale duke ndihmuar qytetarët të ushtrojnë të drejtën e tyre për të qenë pjesë e procesit të vendim-marrjes.

Në të njëjtën kohë, shpeshherë qytetarët nuk arrijnë të ushtrojnë ndikimin e tyre si rezultat i mungesës së vullnetit, njohurive dhe kapaciteteve në procesin e vendimmarrjes jo vetëm nga KL-të por edhe në vetë komunat. Për të trajtuar këtë problem, Iniciativa për Progres (INPO) ka bërë analizën, “Roli i Këshillave Lokale dhe Funksionimi i Tyre – Komuna e Ferizajt”, në të cilën shtjellohet përbërja dhe roli i KL-ve në procesin e zhvillimit të politikave lokale publike, zgjidhjen e problemeve, dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Të dhënat e prezantuara në këtë analizë janë specifike të cilat shpjegojnë rolin dhe gjendjen e KL-ve në Komunën e Ferizajt. Fillimisht, ky dokument shtjellon aspektin ligjor dhe teorik, dhe më pas atë praktikë të funksionimit të KL-ve, në të cilin kontekst identifikohen problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen KL-të, duke ofruar në fund një listë të sugjerimeve për fuqizimin e rolit të KL-ve.

Konteksti

Funksionimi i KL-ve në zhvillimin e qeverisjes lokale shpjegohet nga dy këndvështrime: (i) mënyrat dhe procesi se si janë formuar, zgjedhur dhe konsoliduar KL-të, të shpjeguara në pjesën e “Integritetit Zgjedhor” të kësaj analize, dhe (ii) angazhimi i KL-ve në raport me komunën dhe banorët/qytetarët, të shpjeguara në pjesën e “Llogaridhënies Institucionale” të këtij raporti. Këndvështrimi i parë i referohet kryesisht procesit zgjedhor të KL-ve duke vlerësuar deri në ç’masë legjislacioni i vetëqeverisjes lokale është i aplikueshëm në praktikë, derisa këndvështrimi i dytë i referohet qeverisjes dhe menaxhimit të KL-ve bazuar në kompetencat e deleguara nga komuna. Kjo qasje e studimit është përdorur edhe në vlerësimin e funksionimit të KL-ve në Komunën e Prishtinës.

Në teori, KL-të ekzistojnë, duke u bazuar në logjikën e *parimit të subsidiaritetit*, që nënkupton se autoritetet qendrore duhet t’i kryejnë funksionet e tyre të cilat nuk mund të kryhen në nivel lokal.¹ Një parim i tillë është i rregulluar në legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE-së), i cili promovon afërsi sa më të madhe në mes autoriteteve publike dhe qytetarëve, jo vetëm në aspektin e komunës si një prej autoriteteve kryesore lokale, por edhe në aspektin e KL-ve, të cilat, në teori, më lehtë dhe drejtpërdrejtë do mund t’i zgjedhin problemet e qytetarëve në bashkëpunim me komunën.

Legjislacioni ekzistues, përfshirë *Ligjin për Vetëqeverisje Lokale* dhe *Statutin e Komunës së Ferizajt*, nuk definojnë saktë lidhjen në mes komunës dhe KL-ve se si duhet përfaqësuar sa më afër interesin e qytetarëve. Në fakt, fjala “*Këshillat/Bashkësitë Lokale*” nuk është e përkufizuar në ligjet parësore. Mirëpo, Ligji për Vetëqeverisje Lokale i ofron mundësi grupeve formale dhe jo-formale të komunitetit, përfshirë KL-të, të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për të adresuar nevojat e qytetarëve. Këto të drejta janë të përkufizuara si të drejta kushtetuese

¹ Oxford Dictionary. “Subsidiarity.” <https://en.oxforddictionaries.com/definition/subsidiarity> [Qasur më 24 gusht 2018].

sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në kontekst të së cilës i referohet *Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale*.

Korniza ligjore

Sipas legjislacionit për vetëqeverisje lokale, çdo komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane brenda territorit të saj me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve.² Në këtë rast, vetëm me aprovimin e komunës, *bashkësitë lokale* mund të kryejnë aktivitete dhe ofrojnë shërbime – vetë apo në mënyrë të kombinuar – që janë pjesë e përgjegjësisë dhe kompetencave të komunës. Sipas ligjit, Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal (MAPL) “lëshon udhëzime për marrëveshjet ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve [të përfaqësuara nga *bashkëshitet lokale*].” Në të njëjtën kohë, rregulloret e komunës përcaktojnë më detajisht formën e bashkëpunimit në mes komunës dhe bashkësive lokale.

Statuti i Komunës së Ferizajt rregullon kompetencat dhe pushtetin e saj, organet e komunës dhe shërbimin civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit, administrimin financiar dhe konfliktin e interesave.³ Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës, është i obliguar që të siguroj kushte për të mundësuar që të gjitha shërbimet komunale të shtrihen në KL-të. Në mënyrë që kjo të arrihet, Kryetari i Komunës duhet të bashkëpunoj me KL-të.⁴ Megjithatë, definimi i një bashkëpunimi të tillë nuk është i rregulluar në Statutin e Komunës së Ferizajt. Për shembull, në Komunën e Ferizajt, Statuti i saj definon që bashkëpunimi me KL-të duhet të rregullohet me shkrim nga Kuvendi i Komunës, zbatimi i së cilës duhet të mbikëqyret në baza vjetore.⁵

Në të njëjtën kohë, në Ferizaj, organizimi si dhe bashkëpunimi me këshillat lokale është i rregulluar me detajisht sipas *Rregullores për Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet, dhe Zonat Urbane*, e cila është adaptuar në shtator 2012.

² Ligji nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008. Neni 34, fq. 10.

³ Komuna e Ferizajt. Statuti. Qershor 2013. Neni 1-9, fq. 2-4.

⁴ Komuna e Ferizajt. Statuti. Qershor 2013. Neni 14, fq. 7.

⁵ Komuna e Ferizajt. Statuti. Qershor 2013. Neni 14, fq. 7.

Në këtë rregullore, përcaktohen kriteret si dhe mekanizmat e bashkëpunimit në mes komunës dhe entiteteve të përfaqësuara nga KL-të, përfshirë fshatrat, vendbanimet dhe zonat urbane, në “ofrimin e shërbimeve publike, ndërtimin e infrastrukturës, mbrojtjen, rregullimin dhe mirëmbajtjen e ambientit dhe plotësimin e nevojave kulturore, sportive dhe rekreative”.⁶

Kuvendi i Komunës së Ferizajt, pas konstituimit në rastin e zgjedhjeve, brenda një muaji (apo 30 ditë) përcakton strukturën e KL-ve, duke përfshirë mandatin, kohëzgjatjen e ushtrimit të detyrës së liderëve apo Kryetarëve të KL-ve, e kështu me radhë. Procedurat për zgjedhjen e udhëheqësve të KL-ve janë të definuara në Statutin e Komunës (Neni 11) dhe *Rregulloren për Bashkëpunimin e Komunës me KL-të* (Neni 6). Këshilli për organizimin e zgjedhjeve krijohet pas thirrjes së Kryetarit të tanishëm të KL-së. Në vendbanimet, fshatrat, dhe lagjet urbane ku nuk ka Kryetar, Kryetari i Komunës është i obliguar të themeloj Këshillin i cili do të bartë përgjegjësinë për organizimin e procesit zgjedhor.⁷

Këshilli nismëtar propozon tre (3) anëtarë të Komisionit për Organizimin e Procesit të Votimit, dhe pesë (5) anëtarë të Komisionit për numërimin dhe shpalljen e votave, të cilët miratohen sipas një procesi të hapur të votimit. Të gjithë qytetarët e lokacionit përkatës, mbi moshën 18 vjeçare, dhe që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje votojnë kandidatët për anëtar të KL-se dhe Kryetarin e KL-së, i cili zgjedhet me shumicën e votave. Pas zgjedhjes së tyre, lista i dërgohet Kryetarit të Komunës së Ferizajt, e cila duhet të verifikohet nga Kuvendi i Komunës.

Komuna duhet të zhvilloj bashkëpunim me KL-të bazuar në detyrat të cilat i transferohen atyre për t'i plotësuar. Në mënyrë që bashkëpunimi të jetë më i efektshëm, komuna dhe KL-të duhet të informojnë njëra tjetrën për problemet që lidhen me plotësimin e obligimeve dhe detyrave në mbrojtje të interesit publik. Disa prej detyrave kryesore që i imponohen KL-ve sipas Rregullores në fuqi përfshijnë: organizimin e takimeve me banorët e fshatrave, zonave urbane dhe vendbanimeve për të diskutuar problemet dhe zgjidhjet e problemeve me

⁶ Rregullore e Komunës së Ferizajt nr.67 (RR-01-67/12-K.FR) për Bashkëpunim e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Zonat Urbane. Shtator 2012. Neni 1, fq. 2.

⁷ Po aty. Neni 6, fq. 5.

karakter publik, paraqitjen e propozimeve të qytetarëve në projekt buxhet në mënyrë që të aprovohet nga komuna dhe të inkorporohet në prioritetet strategjike të planit zhvillimor të komunës, etj.

Sipas Statutit të Komunës, komuna duhet të organizoj së paku dy (2) takime publike në vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe tjetrin në gjashtëmujorin e dytë. Gjithashtu, komuna duhet të informoj publikun për takimet (vendin, datën dhe kohën e mbajtjes) së paku dy javë para mbajtjes së tyre. Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij duhet të përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë takimit dhe nuk do të lejojë diskutime për çështje të cilat nuk janë në rend të ditës apo që nuk janë në kuadër të pushtetit të komunave dhe përgjegjësitë dhe punët e komunës.⁸

⁸ Po aty. Neni 76-77, fq. 13.

Struktura dhe organizimi

Si janë te strukturuar dhe organizuar Këshillat Lokale (KL-të) në Komunën e Ferizajt?

Komuna e Ferizajt ka rreth 110,000 banorë, prej tyre gjysma jetojnë në qytet dhe gjysma në fshatra. Ajo është e përbërë nga qyteti, katërdhjetë e pesë (45) fshatra, si dhe tetë (8) zona urbane. Territori i komunës është i përcaktuar sipas Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave, me qëllim që qytetarët të kenë mundësinë e realizimit të të drejtave dhe interesave të tyre në të gjitha fushat e jetës.

Tabela 1. Të dhënat lidhur me Bashkësitë Lokale në Komunën e Prishtinës

| | Bashkësia lokale urbane | Bashkësia lokale rurale | Gjithsej |
|---------------------------|-------------------------|-------------------------|----------|
| Numri i bashkësive lokale | 8 | 45 | 53 |

Procesi dhe integriteti zgjedhor

Sa janë Këshillat Lokale (KL-të) *legjitime* si rezultat i një procesi zgjedhor demokratik?

Kjo pjesë e analizës shtjellon procesin zgjedhor të Këshillave Lokale (KL-ve). Në Komunën e Ferizajt ka më shumë se katër vite që KL-të nuk janë funksionale. INPO që nga viti 2016 në vazhdimësi ka organizuar takime informuese dhe koordinuese me përfaqësues të KL-ve për rëndësinë e funksionalizimit të KL-ve. INPO në fund të vitit 2016, i ka dërguar një kërkesë Kryetarit të Komunës për të adresuar nevojën e organizimit të zgjedhjeve, mirëpo asnjëherë nuk ka pranuar përgjigje nga Kryetari. Në mungesë të vullnetit politik për të organizuar zgjedhje për kryetarë të KL-ve, tash e sa vite KL-të nuk janë funksionale në kryerjen e obligimeve të tyre për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të qytetarëve.

Tubimet zgjedhore

Në të kaluarën, në zgjedhjet e KL-ve në Ferizaj, pjesëmarrja e qytetarëve në procesin zgjedhor ka qenë e ulët dhe e politizuar. Varësisht nga përbërja e elektoratit, partitë kanë arritur të ndikojnë që militantët e tyre të ndikojnë në procesin e zgjedhjeve të përfaqësuesve të KL-ve. Të gjeturat kryesore të nxjerra gjatë analizës së këtij punimi janë të prezantuara si në vijim duke marrë parasysh që ka më shumë se 4-5 vite që në komunën e Ferizajt nuk ka pas organizim të zgjedhjeve të KL-ve.

Nuk është ofruar qasje e plotë në procesverbalin lidhur me mbajtjen e tubimeve të cilat përmbajnë listën e pjesëmarrësve dhe të dhënat mbi procesin e zgjedhjes së anëtarëve. Ueb-faqja e komunës nuk është e pasuruar me informata të cilat tregojnë ndonjë informata për procesin zgjedhor. Kjo nënkupton edhe informatat lidhur me listat e përfaqësuesve të zgjedhur të cilat shkojnë nëpërmjet zyrës së Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal për verifikim. Për më tepër, nuk është ofruar as qasje e plotë në procesverbalin e mbajtjes së tubimeve të cilat përmbajnë listën e pjesëmarrësve dhe të dhënat mbi procesin e zgjedhjes së anëtarëve.

Tubimet zgjedhore nuk kanë përmbushur standardet minimale të pjesëmarrjes së qytetarëve të cilat kanë qenë pjesë e procesit të zgjedhjeve të përfaqësuesve të KL-ve. Kjo është vërtetuar në bazë të vëzhgimit të procesit nga INPO dhe shoqëria civile. Në të njëjtën kohë, komuna nuk ka ofruar të dhëna zyrtare të cilat mund të verifikojnë nëse ka pas apo nuk ka pas pjesëmarrje të mjaftueshme. Komuna e Ferizajt ende nuk ofron të dhëna në ueb-faqen e saj lidhur me raportimin e Komisioneve të krijuar për organizimin e zgjedhjeve në Kuvendin e Komunës.

Komisioni i politizuar

Komisioni për zgjedhjen e KL-ve ka qenë tejet i politizuar si pasojë e ndikimit të madh politik nga partitë politike kryesore në Komunën e Ferizajt. Sipas raporteve të brendshme të INPO-së, të hartuara gjatë procesit të zgjedhjeve, procesi zgjedhor ka shërbyer më shumë si vegël e partive politike për të kontrolluar elektoratin. Komisioni ka predispozita që të jetë i politizuar dhe të mos lejoj ndryshime pasi që thirret nga Kryetari i vetë KL-së. Kjo i jap mundësi të plotë Kryetarit të KL-së të vendosë sa i përket drejtimit të procesit zgjedhor. Pasi që tash e sa vite nuk ka pas zgjedhje të organizuara për mandatin e ri të kryetarëve të KL-ve, kjo tregon që partitë politike dëshirojnë të mbajnë *status quo-në*.

Tani pasi që KL-ve i ka kaluar mandati dhe nuk janë funksionale, Kryetari i Komunës ka për obligim ligjor të themeloj Këshillin nismëtar për organizimin dhe procedimin e mbledhjes për zgjedhjen e përfaqësuesve të KL-ve. INPO ka bërë një thirrje të tillë tash e tri vite sepse në mungesë të KL-ve funksionale, mund të rrezikohet interesi publik dhe të zbehet lidhja në mes banorëve dhe përfaqësuesve të KL-ve. Sipas Rregullores, mandati, dhe kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës së përfaqësuesve të KL-ve është drejtpërdrejtë e lidhur dhe zgjatë sipas mandatit zgjedhor komunal.⁹

⁹ Po aty. Neni 4, fq. 4.

Informimi i mangët

Në Komunën e Ferizajt, informimi i qytetarëve për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarin e KL-ve nuk ka qenë i mjaftueshëm pasi që Komisioni nismëtar dhe/apo organet kompetente, përfshirë Kryetarin e Komunës, nuk kanë treguar punë profesionale në njoftimin e banorëve për procesin në mënyrë që të sigurojnë pjesëmarrjes sa më të kënaqshme dhe a-politike. Në këtë rast, Zyra për Informim nuk ka ndihmuar sa i përket shpalljes publike në vendet më të frekuentuara si dhe shpalljes nëpërmjet mediave sociale. Kjo zyrë duhet të jetë më e aftësuar në angazhimin e saj për të organizuar zgjedhje në të ardhmen duke ofruar informata qytetarëve mbi procesin zgjedhor dhe të drejtat e tyre.

Mirëpo, në Komunën e Ferizajt, siç është edhe në shumicën e komunave tjera, Kryetari ka ndikuar negativisht në integritetin e procesit zgjedhor duke vepruar selektivisht në procesin e informimit lidhur me zgjedhjet. Kjo ndodh në rastet kur Zyra për Informim është e ndikuar nga Kryetari, dhe kur ajo nuk ka plan të veprimit se si duhet bërë shpërndarja e informimit, p.sh. në informimin e qytetarëve nëpërmjet mediave të ndryshme, përfshirë mediat sociale, si dhe metodat përmes telefonit për grupet e targetuara në fshatra të cilat nuk kanë qasje në internet.

Procesi i ankimit

Komuna e Ferizajt nuk ka ofruar të dhëna të mjaftueshme mbi numrin e ankesave që janë parashtruar gjatë procesit zgjedhor në zgjedhjet e kaluara. Mungesa e të dhënave lidhur me procesin zgjedhor tregon që mekanizmat e llogaridhënies në mes komunës, KL-ve, dhe gjithë qytetarëve janë shumë të dobëta. Përveç tjerash, jo transparenca e komunës lidhur me publikimin e ankesave dhe adresimin e tyre ka ndikim të madh edhe në dekurajimin e qytetarëve që të ngritin zërin për të adresuar problemet e tyre. Si rezultat, qytetarët janë më pak të zëshëm lidhur me kërkesat e tyre, dhe kanë më pak vullnet të organizohen për të adresuar çështje me interes të përbashkët të komunitetit ku ata jetojnë.

Llogaridhënia institucionale

Sa i ofrojnë Këshillat Lokale (KL-të) llogari Komunës së Ferizajt dhe publikut?

Kjo pjesë e analizës shtjellon qeverisjen e Këshillave Lokale (KL-ve) në relacion me Komunën e Ferizajt si dhe banorët e saj.

Përfshirja në politikbërje

Mënyrat se si organizohen takimet publike janë të rregulluara sipas Statutit të Komunës së Ferizajt. Takimet publike janë të njohura edhe si takime konsultative për të cilat qytetarët lajmërohen nëpërmjet mediave, një javë para mbajtjes së tyre. Në kontekst të Komunës së Ferizajt, këto takime më shumë shërbejnë si takime për planifikim buxhetor, që ndërlidhen me prioritetet e komunës. Nga këto takime, të gjitha propozimet që ofrohen nga banorët e qytetit, fshatrave apo zonave urbane, përfshirë përfaqësuesit e KL-ve, dërgohen në komunë për diskutim dhe aprovim.

Deri më tani, pjesëmarrja e banorëve në takimet publike apo konsultative në Ferizaj nuk ka qenë e mjaftueshme. Sfidat kryesore e komunës për të siguruar pjesëmarrje janë si rrjedhojë e informimit të dobët nga Zyra për Informim e cila nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të informuar sa më shumë banorë lidhur me rëndësinë dhe përmbajtjen e takimeve publike. Anëtarët e KL-ve nuk përfshihen mjaftueshëm në takimet publike dhe grupet punuese për planifikimin e planeve urbane, zhvillimore dhe rurale në lokalitetet ku ata/ato jetojnë. Se sa janë të përfshirë KL-të në grupet punuese nuk është zbuluar, në mungesë të procesverbaleve të komunës, mirëpo vëzhgimet dhe intervistat në terren tregojnë që komuna nuk organizon takime të mjaftueshme për zhvillimin e politikave, në të cilat raste ka mungesë të qytetarëve.

Sipas Statutit të Komunës (Neni 76) dhe Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale, komuna duhet të organizojë së paku dy (2) takime në vit me publikun, një në gjashtëmujorin e parë dhe tjetrin në gjashtëmujorin e dytë. Në praktikë, në të dy takimet thirren Kryetarët apo përfaqësuesit e KL-ve si dhe qytetarët e tjerë të

interesuar për të ofruar kontributin e tyre në hartimin e politikave dhe zgjidhjen e problemeve në komunitet. Se sa komuna respekton këtë obligim ligjor ende mbetet e pa njohur pasi që në ueb-faqen e komunës nuk janë publikuar procesverbalet për organizimin e takimeve publike, me përjashtim të një debati publik për hartat zonale, të organizuar në muajin Maj 2018.¹⁰

Derisa Komuna e Ferizajt nuk vlerëson kontributin e banorëve, e sidomos të KL-ve që mund të ofrojnë në zhvillimin e politikave, një qasje e tillë cenon vullnetin e KL-ve për të iniciuar apo organizuar iniciativa të konsultimit publik për të zgjidhur problemet në komunitetin ku ato funksionojnë. Gjatë hulumtimit për këtë analizë, INPO nuk ka arritur të evidentoj numrin e takimeve të KL-ve jashtë takimeve të organizuara me komunën. KL-të rrallë herë organizojnë takime me qytetarët si rezultat i mungesës së vullnetit.

Komuna e Ferizajt është e obliguar të jetë sa më e hapur ndaj publikut. Në mungesë të informatave më thelbësore mbi pjesëmarrje, diskutim dhe adresim të çështjeve të nxjerra nga takimet publike, ajo humb besimin e publikut për qeverisjen e saj. Më poshtë është e paraqitur qasja e mangët e ofruar nga komuna sa i përket publikimit të proces-verbaleve të takimeve publike. Me përjashtim të vitit 2018, kur është mbajtur vetëm një takim publik, komuna nuk ka ofruar informata për asnjë vit tjetër që nga viti 2017.

Ferizaj > DEBATET PUBLIKE DREJTORIA E URBANIZIMIT, HARTAT ZONALE > Proces Verbalet e mbledhjeve

TE GJITHA

ANKESAT

PREZANTIMET

PROCES VERBALET E MBLEDHJEVE

PROCES VERBALET E MBLEDHJEVE

2018 2017 2016 2015 2014 2013 Tjera

NUK KEMI GJETUR

¹⁰ Komuna e Ferizajt. Procesverbali i parë i debatit publik për hartat zonale. Maj 2018, fq. 1-2. I qasshëm përmes: <https://kk.rks-gov.net/ferizaj/wp-content/uploads/sites/31/2018/05/Procesverbal-i-drejtorise-se-urbanizimit.pdf>

Mungesa e vullnetit të Komunës për të bashkëpunuar me qytetarët është tregues i mirë se sa KL-të janë funksionale në Ferizaj. Mbi të gjitha, INPO, sipas hulumtimeve në terren, ka vërtetuar që KL-të nuk janë funksionale pasi që kushtet për të punuar nuk janë të përshtatshme. Ka më shumë se katër vite që Komuna e Ferizajt nuk ka shprehur vullnet të mirë për krijimin e KL-ve, dhe asnjëra nga kërkesat e INPO-së nuk është marrë për bazë nga Kryetari i Komunës. Në shumë raste, KL-të nuk kanë zyra dhe/apo pajisje të nevojshme për të punuar, si rezultat i mungesës financiare të ofruar nga komuna.

Performanca e Komunës së Ferizajt lidhur me organizimin e takimeve publike më së miri vërtetohet sipas treguesit të matjes së performancës së komunës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) duke iu referuar atyre sipas renditjes-treguesit nën fushën e transparencës lokale të renditur nga 2.1.1 deri në 2.1.4. Shih tabelën më poshtë në të cilën janë prezantuar vlerat (në përqindje) për secilin tregues apo indikator.¹¹

| Ref. | Treguesi | Vlera/ % |
|-------|--|---------------|
| 2.1.1 | % e mbledhjeve të kuvendit & komisioneve komunale të bëra publike për qytetarët | 100.00 |
| 2.1.2 | % e akteve të miratuara në kuvendin komunal për të cilat është konsultuar publiku | 3.67 |
| 2.1.3 | Konsultimi i publikut për miratimin e kornizës afatmesme dhe buxhetit komunal | 100.00 |
| 2.1.4 | % e njoftimeve të publikuara për mbajtjen e dy takimeve publike | 100.00 |

Siç është e ilustruar në tabelën më lartë, Komuna e Ferizajt është vlerësuar me performancë më të dobët sa i përket nivelit të akteve të miratuara në Kuvendin e Komunës për të cilat është konsultuar publiku. Sipas Raportit të Performancës së MAPL-së, më pak se 5% të akteve komunale i janë nënshtruar konsultimit publik

¹¹ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Raporti i Performancës së Komunave 2017. Qershor 2018, fq. 40. I qasshëm përmes: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Raporti-1.docx>

(një prej performancave më të dobëta sipas MAPL-së krahasuar me komunat tjera). Në të njëjtën kohë, konsultimi i publikut për miratimin e kornizës afatmesme dhe buxhetin e komunës i përmbush standardet minimale të konsultimit siç kërkohet me ligj.

Në fushën e transparencës, komuna ka treguar performancë më të mirë sa i përket nivelit të publikimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe Komisioneve Komunale, duke plotësuar normën maksimale në 100%. Gjithashtu, komuna ka treguar performancë të mirë sa i përket publikimit të njoftimeve për mbajtjen e takimeve publike. Mirëpo, këto janë matje kuantitative të plotësuara nga zyrtari koordinues për menaxhim të performancës, dhe nuk tregojnë gjendjen reale dhe kualitative se si bëhet organizimi dhe njoftimi i takimeve publike. Në shumë raste siç u dokumentua edhe më herët, Komuna e Ferizajt ka treguar transparencë të ulët (p.sh. mungesa e procesverbaleve), dhe ky fakt tregon që komuna nuk vlerëson mjaftueshëm nevojën e përfshirjes së KL-ve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes.

Takimet me Kryetarin

Siç është cekur edhe më lartë, Komuna duhet të organizoj së paku dy takime publike, në të cilat ftohen të marrin pjesë përfaqësuesit e KL-ve. Është vështirë të dokumentohet që këto takime janë mbajtur në të kaluarën pasi që komuna nuk ofron informata dhe procesverbale në ueb-faqen e saj, duke përjashtuar vetëm një takim të organizuar në vitin 2018. Sipas vëzhgimeve në terren, Kryetari i Komunës së Ferizajt nuk ka shprehur vullnet për të takuar KL-të. Shumë përfaqësues (me mandat të skaduar tash e sa vite) kanë raportuar qa ata nuk kanë takuar Kryetarin, në të njëjtën kohë ai nuk ka ofruar përgjigje ndaj kërkesave të parashtruara nga KL-të ekzistuese.

Me përjashtim të numrit të kufizuar të takimeve me Kryetarin, shpeshherë KL-të raportojnë në takimet me INPO-në mbi sfidat dhe problemet të cilat ato nuk mund t'i adresojnë pa mbështetje të Kryetarit të Komunës. Një numër i kërkesave

të parashtruara nga KL-të në Komunën e Ferizajt janë prezantuar në tabelën më poshtë në bazë të kategorive të ndryshme:¹²

Kërkesat e parashtruara nga KL-të në Komunën e Ferizajt (2018)

Rregullim i trotuareve, rrugëve, objekteve dhe varrezave

Sigurimin e ujit të pijshëm në pjesë të disa fshatrave

Ndriçim i rrugëve në disa pjesë të fshatit aty ku mungon ndriçimi

Ndërtim dhe/apo renovimi i çerdheve publike dhe shkollave

Pastrimi i mbeturinave

Krijimi i një stacioni të autobusëve

Në rastin konkret, nga kërkesat e drejtuara tek Kryetari i Komunës në vitin 2018, shumica nga këto kërkesa ende mbesin të paadresuara. Trend i ngjashëm është përcjell edhe në vitin 2017. Nga ky këndvështrim, duhet theksuar që mungesa e vullnetit nga ana e Komunës për t'i dëgjuar kërkesat e KL-ve është një ndër problemet kryesore. Më konkretisht, kryetari nuk ka vullnet t'i adresoj kërkesat e KL-ve.

Përgjegjësitë e bartura

Në Komunën e Ferizajt, KL-të deri më tani nuk kanë kërkuar nga Kryetari apo Kuvendi i Komunës transferimin e ndonjë përgjegjësie brenda kompetencave ekskluzive vetanake të komunës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale më së miri i definon kompetencat e transferueshme, disa prej të cilave përfshijnë: zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin dhe zhvillimin e tokës, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit, ofrimin & licencimin e shërbimeve publike, ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, përkujdesin publik shëndetësor (primar), sigurimin e mirëqenies sociale dhe

¹² Iniciativa për Progres (INPO). *Raport i Brendshëm: Takimet Jo-Formale me Bashkësitë Lokale*. Komuna e Ferizajt. 2018.

banimit publik, emërimin e rrugëve dhe vendeve, mirëmbajtjen e hapësirave publik, zhvillimin e turizmit.

INPO deri më tani nuk iu ka qasur ndonjë marrëveshje në mes komunës dhe KL-ve. Në të njëjtën kohë, komuna nuk ka të publikuar ndonjë marrëveshje në ueb-faqen e saj, kështu që nuk dihet se si duhet të dukej një marrëveshje. Si rrjedhojë, kjo vlerësohet si pengesë ligjore për funksionalizimin e KL-ve. Në këtë kontekst, rregullorja nuk e konkretizon se si duhet një model i marrëveshjes në mes komunës dhe KL-ve të zhvillohet.

KL-të në Komunën e Ferizajt janë shumë të dobëta për të pranuar bartjen e kompetencave, e cila rezulton në hezitimin e komunës për të bërë një gjë të tillë. Për këtë arsye, KL-të nuk kanë mbështetje financiare nga Kryetari i Komunës, çfarë kishte për të ndihmuar KL-të në plotësimin e standardeve minimale të funksionimit. Në mungesë të informatave nga komuna, nuk dihet saktë numri i KL-ve që nuk kanë zyre apo lokacion të përcaktuar. Mirëpo, sipas vlerësimit të INPO-së në terren, një numër i konsiderueshëm i KL-ve funksionojnë pa zyre.

KL-të në Ferizaj rrallë herë takohen për të shqyrtuar çështjet me interes për komunitetin. Për këtë arsye, ato nuk hartojnë dhe miratojnë planet e punës dhe rregullat e brendshme në mënyrë që të jenë më efektive në punë e tyre dhe në bashkëpunimin me komunën. Është theksuar shpeshherë në punët e INPO-së në terren që KL-të nuk organizojnë takime me vetë iniciativën e tyre si rezultat i mungesës së kushteve minimale për punë. Në shumicën e rasteve, Kryetari i kryen punët dhe përgjegjësitë e KL-së, të cilët shpeshherë mund të jenë edhe të lidhur politikisht me Kryetarin e Komunës. Në përgjithësi, përfaqësuesit e KL-ve të cilët nuk janë të lidhur politikisht janë më të kufizuar në ushtrimin e ndikimit të tyre në komunë për të adresuar problemet e komunitetit që ata përfaqësojnë.

Në shumicën e rasteve, banorët e qytetit, fshatrave dhe zonave urbane parashtrajnë kërkesat si dhe ankesat e tyre në mënyrë individuale tek komuna. Kjo ndodh pasi që përfaqësuesit e KL-ve nuk janë aktiv në përfaqësimin e interesave të banorëve si dhe në përmbushjen e kërkesave publike. Andaj, banorët hezitojnë t'i drejtojnë kërkesat e tyre përmes Kryetarit të KL-ve, kryesisht për shkak se nuk i besojnë kryetarëve të zgjedhur të cilët në shumicën e rasteve

janë të politizuar. Gjithashtu, vlen të ceket se në shumicën e rasteve, banorët nuk janë në dijeni se kush janë përfaqësuesit e tyre. Kontakti në mes të përfaqësuesve dhe komunitetit është shumë i dobët.

Qëndrueshmëria financiare

Financimi i aktiviteteve të KL-ve mund të bëhet nga vetë banorët, komuna apo donatorët, në pajtueshmëri të plotë me Statutin dhe rregullat e Komunës së Ferizajt.¹³

Sipas Rregullores, komuna, “në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë të nivelit lokal, mbështet krijimin e kushteve më të volitshme të mjedisit jetësor dhe sipas mundësive buxhetore në mënyrë të mëvetësishme financon dhe bashkë financon me komunitete lokale dhe donatorë realizimin në projekteve të ndryshme në interes të gjithë qytetarëve.”¹⁴

KL-të nuk përgatisin raporte financiare gjashtë mujore dhe vjetore mbi mjetet e shpenzuara, çfarë është e kërkuar nga rregullorja, në mënyrë që KL-të të jenë më transparente ndaj publikut si dhe komunës.

Sipas rregullores, Kryetarët/et e KL-ve mund të kompensohen, nëse është e përcaktuar dhe votuar nga Kuvendi Komunal. Një vendim i tillë në Komunën e Ferizajt nuk është nxjerrë, që do të thotë se përfaqësuesit/et e KL-ve nuk pranojnë ndonjë mëditje apo kompensim për angazhimin e tyre, gjë që bën angazhimin e tyre të konsiderohet më shumë si angazhim vullnetar.

¹³ Rregullore e Komunës së Ferizajt nr.67 (RR-01-67/12-K.FR) për Bashkëpunim e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Zonat Urbane. Shtator 2012. Neni 12, fq. 9.

¹⁴ Po aty. Neni 12, fq. 9.

Rekomandimet

Kryetari i Komunës duhet të thirrë Këshillin nismëtar për organizimin e zgjedhjeve i cili përcakton komisionet përkatëse për organizimin e procesit zgjedhor dhe numërimin dhe shpalljen e rezultateve.

Përmirësimi i komunikimit në mes të Komunës dhe KL-ve është shumë i rëndësishëm. Komunikimi luan një rol jetësor në sigurimin e fuqizimit të komunitetit. Qasja përfshirëse në komunikim inkurajon diskutime dhe debate të cilat mund të rezultojnë në rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin, si dhe në nivel më të lartë të menduarit kritik. Mendimi kritik u mundëson komuniteteve të kuptojnë bashkëveprimin e forcave që veprojnë në jetën e tyre dhe i ndihmon ata të marrin vendimet për gjëra të ndryshme që prekin interesin e tyre.

Zyra për Informim duhet të zhvillojë kapacitetet e saj për të ndihmuar komunën në organizimin e zgjedhjeve të ardhshme të KL-ve duke siguruar pjesëmarrje sa më të mirë të qytetarëve në procesin zgjedhor.

Zyra për Informim duhet të hartoj planin e veprimit se si duhet bërë shpërndarja e informimit, për procesin e zgjedhjeve të KL-ve, dhe cilat janë format e komunikimit të cilat duhet të përdoren për lokalitete të ndryshme.

Shfrytëzimi i kapaciteteve të OJQ-ve në procesin e zgjedhjeve dhe informimin e qytetarëve për pjesëmarrje. Gjithashtu, bashkëpunimi më i madh me organizatat e shoqërisë civile do të mundësonte ngritjen e kapaciteteve të KL-ve rreth mënyrës se si të rrisin pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje, hartim të politikave, monitorim të investimeve dhe prokurimeve të ndryshme, përdorim të mjeteve të komunikimit për të adresuar çështje të ndryshme, etj.

Takimet publike duhet të trajtohen jo vetëm nga këndvështrimi i planifikimit buxhetor, por edhe nga këndvështrimi i nevojës së konsultimit publik për hartimin e politikave publike lokale dhe zgjidhjen e problemeve që prekin interesin e gjerë publik.

Kryetari i Komunës duhet të publikoj të gjitha procesverbalet e organizimit të takimeve publike në mënyrë që të mbaj të informuar publikun dhe të evidentoj

përmbajtjen e diskutimeve, gjë që mund të ndikoj në rritjen e besimit të qytetarëve për një qeverisje të mirë komunale.

Krijimi i një ekipi nga Komuna/Kuvendi e cila do të ofroj ndihmë dhe shërbime mbështetëse për KL-të në aspekt të hartimit të projekt propozime që mundësojnë sigurimin e fondeve për KL-të nga donator të ndryshëm.

Kryetari i Komunës duhet të ju përgjigjet kërkesave të KL-ve. Në rast se kërkesat e shtruara nuk mund të adresohen, së paku Kryetari duhet të ofroj sqarime të arsyeshme se pse nuk mund të zgjedh problemet e identifikuara nga KL-të.

Komuna duhet të hartoj dhe nënshkruaj marrëveshje me KL-të për bashkëpunim në sferat ku KL-të mund të ofrojnë shërbime. Kjo nënkupton që komuna duhet të shprehë gatishmëri t'i ofroj KL-ve kushte minimale për operim. Përcaktimi strategjik i detyrave dhe përgjegjësive për KL-të erajoneve të ndryshme. Për shembull, mbikëqyrja e investimeve infrastrukturore në zona rurale do të ndihmonte procesin e monitorimit dhe raportimit të parregullsisive nga implementuesit.

Për të realizuar funksionet dhe përgjegjësitë e veta të rregulluara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat e Republikës së Kosovës duhet të mbështesin themelimin dhe konsolidimin e Këshillave Lokale, të njohura gjithashtu si Bashkësi Lokale, të cilat përfaqësojnë fshatrat, vendbanimet, dhe lagjet urbane. Një prej lirive thelbësore për zhvillim të demokracisë lokale është e drejta e qytetarëve për të qenë aktiv në proceset e vendimmarrjes. Krijimi i Këshillave Lokal ka për qëllim që të ndihmoj këtë proces duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe praktikën e Bashkimit Europian. Ky dokument shtjellon aspektin ligjor dhe teorik, dhe më pas atë praktikë të funksionimit të Këshillave Lokal, në të cilin kontekst identifikohen problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen Këshillat Lokal, duke ofruar një listë rekomandimesh për fuqizimin e rolit të tyre.

www.inpo-ks.org

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore. Organizata INPO funksionon në bazë të programeve të saj: Programit për Qeverisje të Mirë, dhe Programit për Zhvillim Demokratik.

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

“Ky grant është financuar nga Projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).”